



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT GJIROKASTËR

Nr. 757 / prot.

Gjirokastrë, më 02.09.2026

Lënda: Mbi verifikimin e ligjshmërisë së akteve të depozituara tek Prefekti i Qarkut.

KËSHILLIT TË BASHKISË PËRMET

Përmet

Në zbatim të ligjit nr. 107/2016 "Për prefektin e qarkut", i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit të ligjshmërisë së akteve të depozituara tek Prefekti i Qarkut, ju konfirmojmë si më poshtë:

1. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 79, datë 25.8.2026, "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB nr. 113, datë 17.12.2025, 'Për miratimin e buxhetit të bashkisë viti 2026 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të bashkisë, institucioneve dhe njësive administrative në varësi të saj', i ndryshuar", konfirmohet.

2. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 81, datë 25.8.2026, "Për pranim në shtëpinë e të moshuarve Gjirokastrë", është akt me karakter individual.

Në bazë të nenit 3, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, 'Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë', akt normativ nënligjor është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij. Gjithashtu, neni 4, pika 1, të ligjit nr. 107/2016, "Për prefektin e qarkut", i ndryshuar, përcakton se aktet me karakter normativ janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilave shprehet vullneti i këtyre organeve në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që u drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës, me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njehershme brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore". Ky vendim nuk ka karakteristikat e një akti normativ, pasi nuk ka përmbajtje abstrakte në funksion të vendosjes së një rregullimi të përgjithshëm.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 "Për prefektin e qarkut", i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.

3. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 82, datë 25.8.2026, "Për pranim në shtëpinë e të moshuarve Gjirokastër", është akt me karakter individual.

Në bazë të nenit 3, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, 'Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë', akt normativ nënligjor është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij. Gjithashtu, neni 4, pika 1, të ligjit nr. 107/2016, "Për prefektin e qarkut", i ndryshuar, përcakton se aktet me karakter normativ janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilave shprehet vullneti i këtyre organeve në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që u drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës, me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore". Ky vendim nuk ka karakteristikat e një akti normativ, pasi nuk ka përmbajtje abstrakte në funksion të vendosjes së një rregullimi të përgjithshëm.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 "Për prefektin e qarkut", i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.

4. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 83, datë 25.8.2026, "Për miratimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6%", është akt me karakter individual.

Në bazë të nenit 3, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, 'Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë', akt normativ nënligjor është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij. Gjithashtu, neni 4, pika 1, të ligjit nr. 107/2016, "Për prefektin e qarkut", i ndryshuar, përcakton se aktet me karakter normativ janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilave shprehet vullneti i këtyre organeve në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që u drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës, me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore". Ky vendim nuk ka karakteristikat e një akti normativ, pasi nuk ka përmbajtje abstrakte në funksion të vendosjes së një rregullimi të përgjithshëm.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 "Për prefektin e qarkut", i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.

5. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 84, datë 25.8.2026, "Për miratimin e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë, muaji gusht 2026", është akt me karakter individual.


Në bazë të nenit 3, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, 'Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë', akt normativ nënligjor është çdo shprehje e vullnetit nga një

organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij. Gjithashtu, neni 4, pika 1, të ligjit nr. 107/2016, "Për prefektin e qarkut", i ndryshuar, përcakton se aktet me karakter normativ janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilave shprehet vullneti i këtyre organeve në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që u drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës, me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore.". Ky vendim nuk ka karakteristikat e një akti normativ, pasi nuk ka përmbajtje abstrakte në funksion të vendosjes së një rregullimi të përgjithshëm.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 "Për prefektin e qarkut", i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.

6. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 85, datë 25.8.2026, "Për miratimin e kalendarit të konsultimeve me komunitetin në kuadër të ndarjes administrativo-territoriale të njësisë të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", konfirmohet.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

 **PREFEKTI**

Albana Hasanaj